Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
Nr/Br. 09/17
Date/Datum 24.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH. nr. 09/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 paragrafi 2, pika 2.16, nenit 106, nenit 131 lidhur me nenin 25 paragrafi 9 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej **Nuhi Paçarizi - Kryetar**, duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 09/17, të parashtruar nga operatori ekonomik **"STUDIO HAPSIRA" sh.p.k.** me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Hartimi i detyrës projektuese për teatrin e operës dhe baletit "Dr. Ibrahim Rugova" në Prishtinë",** me nr. të Prokurimit: 207/16/107/236, të shpallur nga autoriteti kontraktues–Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në seancën e dt. 23 shkurt 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik **"STUDIO HAPSIRA" sh.p.k.** me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Hartimi i detyrës projektuese për teatrin e operës dhe baletit "Dr. Ibrahim Rugova" në Prishtinë",** me nr. të Prokurimit: 207/16/107/236, të shpallur nga autoriteti kontraktues–Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

II. **Anulohet,** vendimi i autoritetit kontraktues-Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, njoftim për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Hartimi i detyrës projektuese për teatrin e operës dhe baletit "Dr. Ibrahim Rugova" në Prishtinë",** me nr. të Prokurimit: 207/16/107/236, lënda kthehet ne Ritenderim, nëse AK, edhe mëtutje ka interes.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paparë me ketë ligj.

V. Operatorit ekonomik ankues **"STUDIO HAPSIRA" sh.p.k.** me seli në Prishtinë, konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

VI. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues–Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më dt. 07 nëntor 2016, ka publikuar *Njoftim për Kontratë,* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Hartimi i detyrës projektuese për teatrin e operës dhe baletit "Dr. Ibrahim Rugova" në Prishtinë",** me nr. të Prokurimit: 207/16/107/236.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar 4 (katër) operator ekonomik, ku sipas komisioni të vlerësimit të ofertave 1 (një) operator ekonomik i plotëson kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit, ndërsa 3 (tre) operator ekonomik janë të pa përgjegjshëm pasi që nuk i plotësoj kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Autoriteti kontraktues më 19 dhjetor 2016, ka publikuar njoftimi për dhënie të kontratës.

Kundër vendimit për refuzimi të kërkesës për rishqyrtim, të dt. 16 janar 2017, operatori ekonomik **"STUDIO HAPSIRA" sh.p.k.**. me seli në Prishtinë, në afatin e paparë ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP-ë.

Pikat e ankesës:

Pala ankuese pretendon se autoriteti kontraktues Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje te nenit 7, nenit 10, nenit 24, nenit 27, nenit 28, nenit 40, nenit 51, nenit 56, nenit 59, nenit 60, nenit 64, nenit 67, nenit 69 dhe nenit 108/A të LPP-së.

Ankesa e operatorit ekonomik është e afatëshme dhe është parashtruar nga ana e personit kompetent.

Ankesa është e bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 18 janar 2017, ka autorizuar eksperten shqyrtues për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtues, me datën 30 janar 2017, i dorëzon, panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raport lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet "*Autoriteti kontraktues na ka injoruar duke mos kthyer përgjigje lidhur me kërkesat për sqarim të parashtruar nga ana jonë duke na trajtuar në mënyrë jo-barabartë dhe diskriminues në raport me operatorët tjerë konkurrentë*", bazuar ne shkresat e lëndës sqaron se autoriteti kontraktues pyetjeve të parashtruara nga operatorit ekonomik ankues ne kërkesën për sqarim, nuk i ka shqyrtuar dhe kthyer përgjigje ashtu siç kërkohet ne nenin 53 paragrafi 4 të LPP-së, ku thuhet: *Autoriteti kontraktues menjëherë do të shqyrtojë çfarëdo kërkese të tillë për të përcaktuar nëse operatorët ekonomik kanë apo nuk kanë nevojë për informatat sqaruese ose plotësues të kërkuar në mënyrë që të përgatisin një tender të përgjegjshëm'.*

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 56 dhe 59 të LPP-së respektivisht ku thuhet: *"Pretendimet e AK janë të pa baza dhe të ndikuara qëllimisht, pasi REFRENCA TË OBJEKTEVE SHOQËRORE, nuk specifikohet as në njoftimin për kontratë as në dosjen e tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk e ka specifikuar/precizuar kontratë të natyrës së ngjashme*", bazuar ne letrën standarde mbi tenderuesin e eliminuar, të dt. 16.12.2016, ekspertja shqyrtues sqaron se komisioni i vlerësimit operatorin e ekonomik ankues e ka eliminuar me arsyetim: *tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni kontrata dhe referenca për objekte shoqërore.* Ndërsa në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim thuhet: *Arsyeja e eliminimit të operatorit ekonomik ankues nga gara është se referencat e prezantuara janë projekte të hartuara për Kubëzimin e rrugëve dhe kolektorëve për ujëra të zeza dhe një kontratë për një restorant dasmash.*

Bazuar ne atë që u tha më lartë, ekspertja shqyrtues sqaron se është fakt se arsyet e dhëna në letrën standarde mbi tenderuesin e eliminuar nga autoriteti kontraktues për eliminimin e operatorit ekonomik ankues, nuk qëndrojnë për faktin se në dosjen e tenderit te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale si kriter për kualifikim është kërkuar: *Minimumi Tri Referenca të hartimit te projekteve projektuese për periudhën 2013-2015*, si dëshmi dokumentare: *Të dorëzoj listën e projekteve te përfunduara në periudhën e viteve: 2013- 2015, me dëshmitë e përfundimit, reference apo raport te pranimit të shërbimeve (te përfunduara me sukses),* që rezulton se nuk janë kërkuar të ofrohen si dëshmi referenca të objekteve shoqërore. Mirëpo, lidhur me kërkesën e cekur, operatori ekonomik ankues ka ofruar listën e projekteve të realizuara nga "STUDIO HAPSIRA" sh.p.k. gjatë vitit 2013-2016, ku figurojnë dy projekte të realizuar konform kërkesës së AK-së, ku ka të bashkangjitur kontrata dhe referencat, ndërsa ne dosjen e tenderit janë kërkuar *minimumi tri referenca të hartimit te projekteve projektuese për periudhën 2013-2015.*

Ekspertja shqyrtues gjatë analizimit të dosjen e tenderit, sqaron se te Pjesa II-Përshkrimi i çmimeve, autoriteti kontraktues ka specifikuar njësia 1, sasia paushall. Bazuar në faktin se kjo kontratë nuk është kontratë kornizë, ekspertja shqyrtues sqaron se në rastin konkret autoriteti kontraktues me rastin e mos specifikimit të sasisë te përshkrimi i çmimit në dosje të tenderit, nuk ka respektuar nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores së Prokurimit Publik, ku thuhet se: *autoriteti kontraktues do të specifikojnë sasitë gjatë përgatitjes së materialeve tenderuese përfshirë publikimet, materialet tenderuese dhe kontratat.*

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomin ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 108/A të LPP-së, ekspertja shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues ka parashtruar pranë autoritetit kontraktues kërkesën për rishqyrtim. Ndërsa, autoritetit kontraktues konform nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, me dt. 16 janar 2017, merr vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duke theksuar vetme arsyet e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues .

Bazuar në atë që u tha më lartë, ekspertja shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që të aprovoj si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik ankues, ndërsa autoriteti kontraktues të anuloj njoftimin për dhënie të kontratës të autoritetit kontraktues, të dt. 19 dhjetor 2016, dhe lëndën ta kthej në Ritenderim.

Autoriteti kontraktues Ministria e e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përmes parashtresës me shkrim të dt. 31 janar 2017, njofton panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertizës të dt. 30 janar 2017.

Operatori ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të dt. 02 shkurt 2017, njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet me disa sqarime dhe mendimin e ekspertit shqyrtues të dhëna në raportin e ekspertizës të dt. 30 janar 2017.

Me rastin e procedurës para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit kërkesë për kualfikim, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik ankues, raporti i ekspertes shqyrtues i dt. 30 janar 2017, si dhe parashtresa e autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues mbi raportin e ekspertit shqyrtues.

Ekspertja shqyrtues gjatë seances dëgjimore deklaroj: komisioni vlerësues operatorin ekonomik ankues e ka eliminuar me arsyetim se tenderi juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni ofruar kontrata me referenca për objekte shoqërore. Lidhur me këtë i sqaroj panelit se autoriteti kontraktues në dosje të tenderit te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale ka kërkuar minimum tri referenca të hartimit të projekteve projektuese për periudhën 2013-2015. Si dëshmi dokumentare janë kërkuar të dorëzohet lista projekteve për këtë periudhë me dëshmitë e përfundimit, referenca apo pranimin e shërbimit, që rezulton se nuk janë kërkuar të ofrohen si dëshmi referenca të objekteve shoqërore. Ndërsa operatori ekonomik ankues lidhur me kërkesën në fjalë ka ofruar listën e projekteve. Ku figurojnë dy projekte të realizuara konform kërkesës së AK-së të bashkangjitura kontratat dhe referencat.

Ekspertja shqyrtues ne vazhdim të prezantimit sqaroj se autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit te Pjesa 2. Përshkrimi i çmimit ka specifikuar njësinë 1, sasia "paushall". Andaj duke u bazuar në faktin se kjo nuk është kontratë kornizë, autoriteti kontraktues mos specifikimin e sasisë te përshkrimi i çmimit, nuk ka respektuar nenin 26 par.1 të Rregullores së Prokurimit Publik ku thuhet: AK-së do të specifikoj sasitë gjatë përgatitjes së materialeve tenderuese përfshirë publikimet, materialet tenderuese dhe kontratat.

Bazuar në këtë që ceka më lart, i rekomandoj panelit të aprovoj ankesën e operatorit ekonomik ankues si të bazuar, ndërsa të anuloj vendimin e autoritetit kontraktues njoftim për dhënie të kontratës të datës 19.11.2016, dhe nëse autoriteti kontraktues ka ende interes për këtë aktivitet të prokurimit, lëndën ta kthej në Ritender.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 27 të LPP-së, paneli shqyrtues bazuar ne të gjeturat e ekspertes shqyrtues sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për faktin autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit te Pjesa II-Përshkrimi i çmimeve, ka specifikuar njësia 1, sasia paushall, andaj bazuar në faktin se kjo kontratë nuk është kontratë kornizë, paneli shqyrtues sqaron me rastin e mos specifikimit të sasisë te përshkrimi i çmimit në dosje të tenderit, autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores së Prokurimit Publik, ku thuhet se: *autoriteti kontraktues do të specifikojnë sasitë gjatë përgatitjes së materialeve tenderuese përfshirë publikimet, materialet tenderuese dhe kontratat.*

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 108/A të LPP-së, paneli shqyrtes bazuar ne të gjeturat e ekspertes shqyrtues sqaron se autoritetit kontraktues konform nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, me dt. 16 janar 2017, merr vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duke theksuar vetme arsyet e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues .

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes se tenderit, konstatimeve të cekura në ekspertizën e ekspertes shqyrtues, shqyrtimit të pikave pretenduese të operatorit ekonomik ankues, parashtresës së operatorit ekonomik ankues të dt. 02 shkurt 2017, parashtresës së autoritetit kontraktues, sqarimet e dhëna nga ekspertja shqyrtues gjatë seancës dëgjimore, si dhe duke pasur parasysh faktin se autoriteti kontrakutes në dosjen e tenderit te Pjesa II-Përshkrimi i çmimeve, nuk ka specifikuar sasin siç parashihet ne nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores së Prokurimit Publik, konstatoj se autoriteti kontraktues me rastin e hartimit të dosjes së tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Hartimi i detyrës projektuese për teatrin e operës dhe baletit "Dr. Ibrahim Rugova" në Prishtinë",** me nr. të Prokurimit: 207/16/107/236, nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart, konform nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

KSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës themelore-Departamentit për Çështje Administrative
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 ekzemplar – OE "STUDIO HAPSIRA" sh.p.k.. Prishtinë
1x1 ekzemplar - AK Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së